



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 5

Tiranë – E mërkurë, 7 janar 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 85/2025, datë 12.12.2025	Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme..... 427
Dekret i Presidentit nr. 1, datë 6.1.2026	Për shpallje ligji..... 428
Ligj nr. 89/2025, datë 12.12.2025	Për gjuetinë..... 428
Dekret i Presidentit nr. 2, datë 6.1.2026	Për shpallje ligji..... 446



LIGJ
Nr. 85/2025

PËR RIVLERËSIMIN E PASURISË
SË PALUAJTSHME

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme për
individët

1. Të gjithë individët, të cilët kanë në pronësi pasuri të paluajtshme, kanë të drejtë që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji e deri në datën 31 dhjetor 2026 të bëjnë rivlerësimin e kësaj pasurie me vlerën e tregut. Kërkesat për rivlerësim të dorëzuara pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për të cilat janë kryer pagesat e tatimit, por nuk kanë përfunduar procedurat administrative nga ASHK-ja brenda datës 31 dhjetor 2026, konsiderohen objekt rivlerësimi sipas këtij ligji dhe procedurat administrative përfundojnë deri më 31 mars 2027.

2. Ky rivlerësim mund të bëhet nga një ekspert i licencuar për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme nga institucionet përkatëse ose nga drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

3. Në rast se individ i vendos që të kryejë rivlerësimin me vlerën e tregut, atëherë ai zgjedh një ekspert të licencuar. Aplikimit të tij për rivlerësim të pasurisë së paluajtshme i bashkëlidh edhe aktin e vlerësimit të ekspertit. Në këtë rast, drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës përlllogarisin:

a) bazën e tatueshme, e cila llogaritet si diferenca ndërmjet vlerës së pasqyruar në aktin e vlerësimit të ekspertit, e cila nuk mund të jetë më e vogël se çmimet fiskale në fuqi në momentin e rivlerësimit, dhe vlerës së regjistruar të pasurisë ose vlerës së rivlerësuar, sipas ligjeve të mëparshme të rivlerësimit, për të cilën është

paguar tatimi. Çmimi minimal fiskal dhe vlera e regjistruar e pronës llogariten sipas dispozitave të udhëzimit të përbashkët nr. 34, datë 29.12.2023, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës “Për tatimin mbi të ardhurat nga tjetërsimi i pasurive të paluajtshme”;

b) tatimin që duhet të paguajë individ i për ta regjistruar këtë rivlerësim.

4. Në rast se individ i vendos që rivlerësimi të kryhet me çmimet minimale fiskale në fuqi, atëherë ai aplikon pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe ky fakt shprehet në formularin, që i bashkëlidhet aplikimit të tij për rivlerësim. Në këtë rast, drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës përlllogarisin:

a) bazën e tatueshme, e cila llogaritet si diferenca ndërmjet vlerës së dalë nga rivlerësimi me çmimet fiskale në fuqi në momentin e rivlerësimit dhe vlerës së regjistruar të pasurisë ose vlerës së rivlerësuar, për të cilën është paguar tatimi. Çmimi minimal fiskal dhe vlera e regjistruar e pronës llogariten sipas dispozitave të udhëzimit të përbashkët nr. 34, datë 29.12.2023, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës “Për tatimin mbi të ardhurat nga tjetërsimi i pasurive të paluajtshme”;

b) tatimin që duhet të paguajë individ i për ta regjistruar këtë rivlerësim.

5. Pavarësisht nga mënyra e kryerjes së rivlerësimit, sipas pikës 3 ose pikës 4 të këtij neni, në rastet kur pasuria e paluajtshme rezulton e regjistruar pa vlerë, atëherë si vlerë regjistrimi në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës konsiderohet vlera sipas parashikimeve për vlerën në blerje në dispozitat e udhëzimit të përbashkët nr. 34, datë 29.12.2023, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës “Për tatimin mbi të ardhurat nga tjetërsimi i pasurive të paluajtshme”.

6. Tatimi, që paguhet për regjistrimin e këtij rivlerësimi, është 5 për qind e bazës së tatueshme, që përcaktohet sipas pikave 3, 4 dhe 5 të këtij neni.

7. Për rastet e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, në zbatim të legjislacionit në fuqi për tatimin mbi të ardhurat, të bërë pas rivlerësimit, tatimi llogaritet sipas normave në fuqi mbi fitimin e realizuar, si



diferencë e vlerës, në momentin e kalimit të së drejtës së pronësisë, me vlerën e rivlerësuar për të cilën është paguar tatimi.

Neni 2

Rivlerësimi i pasurive të paluajtshme për personat juridikë

1. Personat juridikë, të cilët kanë të regjistruar në pasqyrat e tyre financiare pasuri të paluajtshme me vlerë më të vogël se ajo e tregut, kanë të drejtë të bëjnë rivlerësimin me vlerën e tregut të këtyre pasurive brenda datës 31 dhjetor 2026.

2. Rivlerësimi me vlerën e tregut bëhet sipas përcaktimeve të nenit 1 të këtij ligji.

3. Diferenca ndërmjet vlerës, që rezulton nga rivlerësimi, me vlerën kontabël të pasurisë reflektohet në pasqyrat financiare të vitit 2026.

4. Personat juridikë për këtë rivlerësim paguajnë 5 për qind të diferencës ndërmjet vlerës së rivlerësimit dhe vlerës kontabël të regjistruar për pasuritë e paluajtshme.

5. Për qëllime të zbatimit të këtij neni, personi juridik mban një kartelë të pasurisë së paluajtshme, ku evidenton vlerën përkatëse të pasurisë së paluajtshme që nga momenti i njohjes fillestare të aktivitetit dhe tatimin përkatës të paguar sipas legjislacionit në fuqi. Diferenca ndërmjet vlerës së rivlerësimit dhe vlerës kontabël të regjistruar nuk është objekt amortizimi për qëllime tatimore. Në rastet kur personi juridik transferon të drejtën mbi pasuritë e paluajtshme të rivlerësuar, për efekt të llogaritjes së fitimit kapital dhe detyrimit tatimor, nga çmimi i shitjes zbritet vlera e rivlerësuar e pasurisë.

Neni 3

Aktet nënligjore

Ngarkohen ministri përgjegjës për financat dhe drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për nxjerrjen e udhëzimit të përbashkët për procedurat e zbatimit të këtij ligji për llogaritjen e bazës së tatueshme, paraqitjen dhe administrimin e kërkesës për rivlerësim, pagesën e tatimit të rivlerësimit, rregullat e procedurat për

pasqyrimin e rivlerësimit të pasurisë në regjistrat e pasurive të paluajtshme, pagesën e të ardhurave nga tatimi i rivlerësimit në buxhetin e shtetit, si dhe për përcaktimin e tarifës së kryerjes së shërbimeve të parashikuara nga ky ligj nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 12.12.2025.

Shpallur me dekretin nr. 1, datë 6.1.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 1, datë 6.1.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 85/2025, “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

LIGJ

Nr. 89/2025

PËR GJUE TINË¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

¹ Ky ligj është përafshuar pjesërisht me Rregulloren e Këshillit nr. 3254/91/KEE, datë 4 nëntor 1991, që ndalon përdorimin e kurtëve kapëse në Komunitet dhe futjen në Komunitet të gëzojësve dhe mallrave të prodhuara të disa specieve të kafshëve të egra me origjinë

nga vendet që i kapin ato me anë të kurtëve kapëse ose metodave të kurtëve, që nuk përmbushin standardet ndërkombëtare humane të kurtëve. Numri CELEX 31991R3254, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 308, datë 9.11.1991, faqe 1–4.

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHMENeni 1
Objekti

Ky ligj ka për objekt:

a) përcaktimin e rregullave dhe kërkesave për zhvillimin e gjuetisë së qëndrueshme, si një veprimtari tradicionale, sportive, çlodhëse, si edhe për të mundësuar mbrojtjen e faunës së egër dhe ruajtjen e biodiversitetit;

b) ofrimin e mekanizmave për menaxhimin e qëndrueshëm të gjuetisë, duke e vlerësuar faunën e egër si pasuri kombëtare, që administrohet dhe mbrohet me ligj;

c) përcaktimin e zonave të gjuetisë, duke përjashtuar specifikisht zonat ku ndalohet veprimtaria e gjuetisë;

ç) përcaktimin e institucioneve përgjegjëse dhe rregullave për monitorimin dhe kontrollin për të garantuar që parimet për gjuetinë të zbatohen në mënyrë rigorozë, duke ruajtur tërësinë e ekosistemit dhe baraspeshën ekologjike.

Neni 2
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

a) të sigurojë mbrojtjen dhe ruajtjen e diversitetit biologjik e të ekuilibrit ekologjik të habitateve natyrore, faunës së egër, florës së egër e të habitateve të tyre gjatë ushtrimit të gjuetisë;

b) të mbrojë të drejtën e gjuetarëve dhe të drejtat për gjahun, për trofetë e produktet e gjuetisë dhe të tregtimit të tyre;

c) të inkurajojë dhe të nxisë bashkëpunimin midis gjuetarëve dhe menaxhuesit të zonës, si dhe mes strukturave të parashikuara në këtë ligj për ruajtjen dhe menaxhimin e faunës së egër dhe të habitatit të saj.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Autorizim për mbajtje arme gjahu” është akti administrativ, i përcaktuar sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për armët.

2. “Gjuetar” është individ që plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 33, të këtij ligji.

3. “Gjueti” është veprimtaria e specializuar e shfrytëzimit të faunës së egër, që ka të bëjë me ndjekjen, kapjen, vrasjen e kafshëve e të shpendëve, objekt gjuetie, me metodat e përcaktuara në këtë ligj.

4. “Gjueti e qëndrueshme” është përdorimi i llojeve të kafshëve, objekt gjuetie, dhe i habitateve të tyre, në një mënyrë dhe sasi të tillë që të mos shkaktojë pasoja të dëmshme afatgjata ndaj biodiversitetit dhe të mos pengojë ripërtëritjen e tij. Përdorimi i tillë krijon mundësinë e ruajtjes së biodiversitetit për të plotësuar nevojat e brezave të tanishëm e të ardhshëm dhe ruan mundësinë që gjuetia të konsiderohet si një aktivitet i pranueshëm social, ekonomik dhe kulturor.

5. “Gjueti reduktuese” është një formë e gjuetisë së kontrolluar, që ka për qëllim uljen e numrit të një lloji të caktuar kafshe.

6. “Gjueti për qëllime kërkimore-shkencore” është një formë e veçantë e gjuetisë, që lejohet vetëm në rrethana të caktuara dhe për qëllime të qarta shkencore.

7. “Kurth” nënkupton një mjet me qëllim mbajtjen ose kapjen e kafshëve përmes kapëseve, të cilat mbyllen fort mbi një ose disa gjymtyrë, duke parandaluar këto gjymtyrë që të shpëtohen nga kurthi.

8. “Lloje të faunës së egër, objekt gjuetie” janë të gjitha llojet e egra të shpendëve dhe gjitarëve tokësorë për të cilat lejohet gjuetia.

9. “Lloje të faunës së egër, objekt gjuetie, në kushte gjysmë të egra” është mbajtja e individëve të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, në kushte të krijuara artificialisht, ku ato ushqehen kryesisht me ushqime natyrore, por nuk kanë mundësi të lëvizin lirshëm jashtë kufijve të pjesës së izoluar të zonës së gjuetisë.

10. “Manual i gjuetarit” është dokumenti, i cili përcakton tërësinë e rregullave dhe kërkesave, që karakterizojnë gjuetinë dhe figurën e gjuetarit.



11. “Menaxhues i zonës së gjuetisë” është personi fizik ose juridik, që menaxhon zonën e gjuetisë sipas parashikimeve në dispozitat e këtij ligji.

12. “Metodika të kapjes së gjahut për ripopullim” janë strategjitë dhe teknikat që përdoren për të kapur individë të specieve të ndryshme të gjahut, me qëllim që të ripërtërihet ose të ruhet popullata e këtyre specieve.

13. “Ministria” është ministria përgjegjëse për gjuetinë.

14. “Ministri” është ministri që drejton ministrinë përgjegjëse për gjuetinë.

15. “Periudhë e folezimit” është periudha në të cilën speciet lëshojnë vezët, kujdesen për to e më pas për të vegjlit deri në mësimin e fluturimit.

16. “Periudhë e riprodhimit” është periudha që përfshin periudhën e shumimit, të zënies së zonës së shumimit dhe të përkujdesjes për të vegjlit deri sa të ndahen nga nëna.

17. “Plan i menaxhimit” është dokumenti zyrtar në bazë të të cilit bëhet menaxhimi i llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, dhe i zonës së gjuetisë.

18. “Plan vjetor i përdorimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie”, është dokumenti që, në përputhje me planin 10-vjeçar të menaxhimit të një zone gjuetie, përcakton me hollësi veprimet për menaxhimin e gjuetisë në një zonë konkrete gjatë një viti.

19. “Produkte të gjuetisë” janë objekte gjuetie të përfuara me anë të veprimtarisë së gjuetisë, të kapura gjallë, të therura, të rrjepura dhe pjesët e tyre, si mishi dhe nënproduktet e tij, përfshirë trofetë e gjuetisë.

20. “Rezerva të mbarështimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie” janë sipërfaqe që përdoren për kultivimin gjysmënatyror të një apo disa llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie.

21. “Rezervë për mbarështimin e llojeve të faunës së egër” është hapësira e përcaktuar me sipërfaqe jo më të vogël se 50 ha dhe e menaxhuar posaçërisht me qëllim rritjen, shumimin dhe ruajtjen e llojeve të caktuara të faunës së egër.

22. “Sezon i gjuetisë” është periudha kohore gjatë së cilës lejohet gjuetia sipas llojit të faunës së egër, objekt gjuetie.

23. “Status i favorshëm i ruajtjes së një lloji” është gjendja faktike e një lloji të faunës së egër, sipas parashikimit në dispozitat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e biodiversitetit.

24. “Status i pafavorshëm i ruajtjes së një lloji” është gjendja faktike e një lloji, kur nuk përmbushen një ose më shumë nga kushtet e përcaktuara në pikën 23 të këtij neni.

25. “Trofe të gjuetisë” janë pjesë të objekteve të gjuetisë së përpunuar, të fituara me anë të gjuetisë, të cilat shfrytëzohen për qëllime shkencore, estetike, kulturore dhe studimore.

26. “Zonë gjuetie” është pjesë e sipërfaqeve tokësore dhe ujore, ku lejohet ushtrimi i gjuetisë për llojet e faunës së egër, objekt gjuetie.

27. “Zona të ripopullimit dhe të kapjes së gjahut për ripopullim” janë pjesë të sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullosor, të paracaktuara për shtimin e popullatave të llojeve të faunës, objekt gjuetie.

Neni 4

Parimet e përgjithshme

Ushtrimi dhe menaxhimi i gjuetisë kryhen në përputhje me këto parime:

a) parimi i gjuetisë së qëndrueshme, sipas të cilit ushtrimi i gjuetisë zhvillohet në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregullatore, që synojnë ruajtjen e biodiversitetit, integritetit të ekosistemeve dhe ekuilibrit ekologjik;

b) parimi i mbështetjes së përpjekjeve për ruajtjen e natyrës në një zonë të caktuar, sipas të cilit gjuetia lejohet vetëm nëse zhvillohet në përputhje me ruajtjen e popullatës së specieve në nivele të qëndrueshme dhe pa dëmton përpjekjet ruajtëse në zonat ku këto specie janë të pranishme;

c) parimi i kontrollit ekologjikisht të balancuar të specieve, sipas të cilit masat ndërhyrëse duhet të jenë të justifikuara, të përshtatshme nga pikëpamja ekologjike dhe proporcionalisht të lidhura me shkallën dhe natyrën e problemit, duke garantuar ruajtjen ose arritjen e statusit të favorshëm të mbrojtjes për speciet përkatëse.

KREU II

LLOJET E FAUNËS SË EGËR, OBJEKT GJUETIE, DHE LLOJET E GJUETISË

Neni 5

Llojet e faunës së egër, objekt gjuetie

1. Gjuetia ushtrohet vetëm ndaj individëve të llojeve të faunës së egër, vendase ose migratore, që jetojnë në gjendje të lirë, në kushte natyrore ose



gjysmë të egra, si dhe ndaj atyre që janë riprodhuar për t'u gjuajtur në zonat e gjuetisë. Individët e llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, miratohen me urdhër të ministrit.

2. Nuk janë objekt i gjuetisë dhe ndalohet gjuetia ndaj individëve:

a) të llojeve të faunës së egër, të mbrojtura nga konventat ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) të llojeve të faunës së egër që janë të rralla, të kërcënuara, në rrezik zhdukjeje dhe që bëjnë pjesë në listën e llojeve të mbrojtura;

c) të të gjitha llojeve të shpendëve të egër migratorë, të cilët, pas vlerësimit të popullatave të tyre, rezultojnë shumë të rralla. Vlerësimi i llojeve migratore është pjesë e inventarizimit të llojit të faunës së egër;

ç) të llojeve të faunës së egër, të përcaktuara në aktet nënligjore në zbatim të legjislacionit në fuqi për faunën e egër.

3. Përfshimisht, gjuetia e individëve të llojeve të ndaluara mund të bëhet në rastet:

a) e shtimit intensiv dhe të pakontrolluar të popullatës së një lloji;

b) e shfaqjes së sëmundjeve infektive, zoonotike në llojet e faunës së egër;

c) e gjuetisë për qëllime kërkimore – shkencore;

ç) e shkakimit të dëmtimeve të vazhdueshme nga individët e një lloji;

d) kur kafsha e egër përbën rrezik të menjëhershëm dhe të paevitueshëm për jetën dhe/ose shëndetin e njerëzve.

4. Në rastet e parashikuara, sipas shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, vrasja e kafshës realizohet në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për veterinarinë dhe autorizohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për veterinarinë dhe të ministrit përgjegjës për gjuetinë.

Neni 6

Gjuetia reduktuese

1. Gjuetia reduktuese lejohet të zhvillohet vetëm kur popullata e një lloji të faunës së egër, e lejuar për gjueti, është shtuar dhe prish ekuilibrin e ekosistemit.

2. Njësia përgjegjëse që mbulon natyrën dhe biodiversitetin pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, pas marrjes së informacionit për shtimin e popullatës së llojit të faunës së egër nga menaxhuesi

i zonës së gjuetisë, shoqatat dhe federatat e gjuetarëve ose institucionet e arsimit të lartë, propozojnë zhvillimin e gjuetisë reduktuese pranë ministrit përgjegjës për gjuetinë.

3. Gjuetia reduktuese kryhet nga gjuetarë të pajisur me leje gjuetie, gjatë ose jashtë sezonit të gjuetisë, në përputhje me metodat dhe procedurat e lejuara të gjuetisë, pas marrjes së autorizimit të ministrit.

4. Dokumentacioni, afati, procedura dhe formati i autorizimit të gjuetisë reduktuese miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për gjuetinë, me propozimin e strukturës përgjegjëse që mbulon gjuetinë në ministri.

Neni 7

Gjuetia për qëllime kërkimore-shkencore

1. Gjuetia për qëllime kërkimore-shkencore përfshin gjuetinë ose zënien e kafshëve të egra për hulumtime shkencore, për qëllime mësimore në institucionet e arsimit të mesëm e të lartë, si dhe për shumim të kafshëve për gjah.

2. Individë të llojeve të faunës së egër që nuk janë objekt gjuetie mund të gjuhen për qëllime kërkimore-shkencore, përjashtimisht vetëm me miratimin e ministrit përgjegjës për gjuetinë.

3. Institucionet, institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor mund të realizojnë veprimtari gjuetie për qëllime kërkimore-shkencore vetëm në bashkëpunim me gjuetarë të pajisur me leje të vlefshme gjuetie, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Pas përfundimit të veprimtarisë së gjuetisë, subjektet e mësipërme kanë detyrimin të dorëzojnë raportin për rezultatet e arritura, duke përfshirë të dhëna të sakta për llojet e individëve të vrarë ose të kapur në strukturën përgjegjëse për gjuetinë pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe pranë strukturës përgjegjëse për gjuetinë në ministri dhe në ministrinë përgjegjëse për shkencën e kërkimin shkencor.

4. Procedura, afatet dhe dokumentacioni i nevojshëm për miratimin e gjuetisë për qëllime kërkimore-shkencore miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për gjuetinë, me propozimin e strukturës përgjegjëse që mbulon gjuetinë në ministri.



KREU III ZONAT E GJUE TISË

Neni 8 Zonat e gjuetisë

1. Gjuetia zhvillohet vetëm në zonat për ushtrimin e gjuetisë që përfshihen në fondin pyjor dhe kullosor jashtë territorit të zonave të mbrojtura, në tokat bujqësore, në sipërfaqet ujore të brendshme, në toka të pafrytshme, të populluara me lloje të faunës së egër, objekt gjuetie, dhe shtrihen në sipërfaqe që janë me pronësi shtetërore apo private.

2. Zonat e gjuetisë, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, shpallen sipas procedurës së parashikuar në nenin 11 të këtij ligji.

Neni 9 Kriteret për shpalljen e zonave të gjuetisë

Shpallja e zonave për gjueti mbështetet në këto kriteret:

a) zona e gjuetisë krijohet në sipërfaqe jo më të vogla se 500 ha në zonat fushore dhe jo më të vogla se 1000 ha në zonat malore, ndërsa rezervatat e mbarështimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, krijohen në sipërfaqe jo më të vogla se 50 ha;

b) zona të mos përfshijë vendbanime dhe qendra ekonomike, tregtare, arsimore, sportive e fetare dhe të ndodhet jo më pak se 300 metra larg prej tyre;

c) zona të jetë në vende ku ushtrimi i gjuetisë nuk përbën rrezik për jetën, shëndetin dhe pronën e njerëzve;

ç) zona të jetë e populluar me llojet e faunës së egër, objekt gjuetie, që jetojnë natyrshëm apo kultivohen në të;

d) zona të ketë kufij në përputhje me relievin;

dh) zona të ketë numër të mjaftueshëm individësh të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, që mund të jetojnë e mbarështohen në atë sipërfaqe, duke mundësuar gjuajtjen e tyre;

e) zonat e gjuetisë në kufi me zonat e mbrojtura që ndodhen jo më pak se 200 metra larg tyre.

Neni 10 Propozimi i zonës të gjuetisë dhe kufijtë

1. Strukturat përgjegjëse për natyrën dhe biodiversitetin pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim me shoqatat dhe

federatat, që operojnë në fushën e gjuetisë, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, i propozojnë ministrisë përgjegjëse për gjuetinë zonat e gjuetisë dhe kufijtë.

2. Propozimi përmban:

a) të dhëna për sipërfaqen, shtrirjen dhe kufijtë e zonës së propozuar;

b) koordinatat, hartën dhe skicat për plan-vendosjen.

3. Mënyrat e shënimit të kufijve të zonës së gjuetisë miratohen me udhëzimin e ministrit përgjegjës për gjuetinë.

Neni 11 Shqyrtimi i propozimit dhe shpallja e zonës së gjuetisë

1. Struktura përgjegjëse për natyrën dhe biodiversitetin në ministrinë përgjegjëse për gjuetinë shqyrton dhe vlerëson propozimin për shpalljen e zonës së gjuetisë, duke mbajtur në konsideratë:

a) dokumentet e paraqitura nga struktura përgjegjëse për natyrën dhe biodiversitetin pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore;

b) përputhshmërinë e propozimit me kërkesat e këtij ligji;

c) përputhshmërinë e propozimit me politikën, strategjitë dhe planet e veprimit për mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit.

2. Struktura përgjegjëse për natyrën dhe biodiversitetin në ministri merr mendimin e Këshillit Kombëtar të Faunës për shpalljen e zonës së gjuetisë para propozimit të aktit për miratim.

3. Zonat e gjuetisë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për gjuetinë.

4. Pas miratimit, koordinatat dhe hartat e zonave për gjueti publikohen në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për gjuetinë dhe të njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore, e cila bën edhe markimin në terren, duke vendosur tabela treguese në hyrje të zonave.

Neni 12 Heqja dhe rishikimi i statusit të zonës së gjuetisë

1. Zonës së gjuetisë mund t'i hiqet statusi si zonë e gjuetisë:



a) për interesa të sigurisë kombëtare dhe për nevoja të mbrojtjes kombëtare;

b) për nevoja të zhvillimit rajonal;

c) për shkak të keqpërdorimit dhe të mbishfrytëzimit;

ç) kur sipërfaqja e saj është zvogëluar nën minimumin e përcaktuar në këtë ligj, si pasojë e ndërhyrjeve të ligjshme.

2. Heqja e statusit miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit, bazuar në kërkesën e argumentuar të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

3. Statusi për zonat e gjuetisë rishikohet çdo 5 vjet nga ministria përgjegjëse për gjuetinë, në bashkëpunim me njësinë e vetëqeverisjes vendore përkatëse dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

Neni 13

Ndryshimi i kufijve të zonës së gjuetisë

1. Kufijtë e zonës së gjuetisë, përveç rasteve të parashikuara në pikën 1 të nenit 12 të këtij ligji, ndryshohen edhe në rastet kur:

a) një pjesë e territorit të një zone të miratuar bëhet e papërshtatshme për zhvillimin e gjuetisë;

b) një pjesë e territorit të një zone të miratuar humbet vlerat ose funksionet për të cilat është shpallur.

2. Propozimi për ndryshim të kufijve të zonës së gjuetisë bëhet pranë ministrisë përgjegjëse për gjuetinë nga njësia përkatëse e vetëqeverisjes vendore.

3. Ndryshimi i kufijve të zonës së gjuetisë miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit, bazuar në kërkesën e argumentuar të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Neni 14

Zonat ku ndalohet ushtrimi i gjuetisë

Ushtrimi i gjuetisë ndalohet në:

a) të gjitha sipërfaqet që nuk përfshihen në zonat e gjuetisë;

b) zonat e mbrojtura;

c) kullotat dhe livadhet në fazën e korrijës;

ç) fushat e kultivuara për prodhimin e varieteteve të farave;

d) vreshtat e mbjellë rishtazi;

dh) vreshtat nga krasitja deri në vjeljen e prodhimit;

e) sipërfaqet e mbjella me drithëra nga 1 prilli deri në përfundimin e korrijës së tyre;

ë) sipërfaqet ligatinore dhe lagunat, që shërbejnë si habitate për shpendët migratorë;

f) sipërfaqet ku zhvillohet akuakultura;

g) parcelat eksperimentale;

gj) hapësirat detare;

h) zonat e shpallura si zona me rëndësi të veçantë për shpendët;

i) zonat urbane dhe industriale;

j) aeroportet, heliodromet, me përjashtim të rasteve kur shpendët përbëjnë rrezik për sigurinë ajrore;

k) rrugët dhe hekurudhat;

l) territoret e reparteve, të bazave e të instalimeve ushtarake;

ll) varrezat dhe oborret e mbyllura;

m) fidanishtet, pemishtet, vreshtat dhe kopshtet e destinuara për prodhim intensiv, në sipërfaqe deri në 100 ha, nëse janë të rrethuara, që pengojnë migrimin natyror të kafshëve të egra;

n) territore ku vërtetohet prania e sëmundjeve me patogjenitet të lartë.

Neni 15

Zona të ripopullimit dhe të kapjes së gjahut për ripopullim

1. Zona të ripopullimit për shtimin e popullatave të llojeve të faunës, objekt gjuetie, shpallen territore të pyjeve dhe kullotave, jo më të vogla se 1 000 ha, në rast se popullatat e një ose disa llojeve, objekt gjuetie, rezultojnë të pakësuara ndjeshëm nga mbigujatja ose për shkaqe të tjera.

2. Njësia përgjegjëse për gjuetinë e njësisë së vetëqeverisjes vendore, në zbatim të objektivave të ministrisë përgjegjëse për gjuetinë, paraqet në ministri propozimet e saj për shpalljen e zonave të ripopullimit në territoret që ato administrojnë.

3. Krijimi i zonave të ripopullimit mbështetet në kërkesat e mëposhtme:

a) zona të ketë qenë tradicionalisht habitat i llojeve që do të ripopullohen;

b) sipërfaqja e saj të jetë biologjikisht e mjaftueshme për jetesën normale të llojeve;

c) zona të plotësojë kushtet për ushqim dhe riprodhim;



ç) shtimi dhe ripopullimi të bëhen me lloje vendase tradicionale;

d) të përcaktohen qartë në terren dhe në harta kufijtë e zonës.

4. Zonat e ripopullimit miratohen me urdhër të ministrit. Gjatë periudhës së riprodhimit në këto zona gjuetia është e ndaluar.

5. Pas ripopullimit këtyre zonave u hiqet statusi si zona të ripopullimit dhe, në varësi të plotësisë së kriterëve, shpallen si zona për gjueti, duke zbatuar procedurat për shpalljen e zonave të gjuetisë, të parashikuara nga ky ligj.

6. Metodikat e kapjes së gjahut për ripopullim në zonën e shpallur për ripopullim propozohen nga njësia e vetëqeverisjes vendore dhe miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për gjuetinë dhe do t'u përmbahen standardeve ndërkombëtare njerëzore për kurthet humane.

Neni 16

Rezervate të mbarështimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie

1. Rezervate të mbarështimit shpallen terriore të pyjeve dhe kullotave, jo më të vogla se 50 ha, në të cilat fauna e egër mbarështohet në gjendje gjysmë të egër me ndërhyrjen e njeriut me ushqim, me kushte strehimi e shumimi.

2. Njësia përgjegjëse që mbulon natyrën dhe biodiversitetin pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, në zbatim të objektivave të ministrisë përgjegjëse për gjuetinë, paraqet në ministri propozimet e saj për shpalljen e rezervateve të mbarështimit në terrioret që ajo administron.

3. Krijimi i rezervateve të mbarështimit mbështetet në kriteret e mëposhtme:

a) zona të ketë qenë tradicionalisht habitat i llojeve që do të mbarështohen;

b) sipërfaqja e saj të jetë biologjikisht e mjaftueshme për jetesën normale të llojeve;

c) zona të plotësojë kushtet për ushqim dhe riprodhim;

ç) shtimi dhe ripopullimi të bëhen me lloje vendase tradicionale;

d) të përcaktohen qartë në terren dhe në harta kufijtë e zonës.

4. Rezervatet e mbarështimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për gjuetinë.

Neni 17

Zonat për stërvitjen e qenve të gjahut

1. Qentë e gjahut stërviten vetëm në zonat për gjueti.

2. Gjuetarët dhe trajnerët respektojnë kufijtë e zonës.

KREU IV

STRUKTURAT PËRGJEGJËSE PËR MENAXHIMIN E GJUEËTISË

Neni 18

Strukturat përgjegjëse për gjuetinë

Strukturat përgjegjëse për zhvillimin e gjuetisë së qëndrueshme janë:

a) ministria përgjegjëse për gjuetinë;

b) njësia e vetëqeverisjes vendore;

c) menaxhuesit e zonave të gjuetisë;

ç) shoqatat dhe federatat që operojnë në fushën e gjuetisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 19

Ministria

1. Ministria është institucioni më i lartë politikëbërës dhe rregullator, që garanton zhvillimin e qëndrueshëm të gjuetisë dhe menaxhimin e faunës së egër dhe të habitatit të saj.

2. Ministria, në përmbushje të rolit të saj, ka këto përgjegjësi:

a) përcakton drejtimitet e politikave për gjuetinë, duke garantuar harmonizimin me prioritetet kombëtare dhe politikat e tjera sektoriale, që lidhen me mbrojtjen e faunës së egër;

b) harton dhe miraton urdhra e udhëzime, si dhe propozon miratimin e akteve nënligjore, në zbatim të këtij ligji;

c) harton programin kombëtar të zhvillimit të gjuetisë;

ç) propozon periudhën e hapjes së sezonit të gjuetisë;

d) bashkëpunon me njësitë e vetëqeverisjes vendore, menaxhuesit e zonës së gjuetisë, institucionet shkencore, organizatat e shoqatave mjedisore dhe shoqatat e federatave, që operojnë në fushën e gjuetisë për monitorimin e faunës së egër.



Neni 20

Njësia e vetëqeverisjes vendore

Njësia e vetëqeverisjes vendore që mbulon natyrën dhe biodiversitetin është struktura vendore për zhvillimin e gjetisë së qëndrueshme në nivel vendor dhe në përmbushje të rolit të saj ka këto përgjegjësi:

- a) propozon shpalljen e zonave të gjetisë, ripopullimit dhe mbarështimit të faunës së egër, objekt gjetie;
- b) kontrollon menaxhimin e zonave të gjetisë, që janë në territorin e tyre dhe kryerjen e veprimtarisë së gjetisë në to;
- c) kryen procedurat për dhënien në përdorim të zonave të gjetisë;
- ç) lidh kontratë me fituesin për dhënien me qira të zonës së gjetisë;
- d) organizon testimin e gjetarëve, në bashkëpunim me shoqatën e gjetarëve dhe federatën, që operon në fushën e gjetisë;
- dh) shqyrton kërkesat për leje gjetie;
- e) administron regjistrin e lejeve të gjetisë;
- ë) grumbullon të dhënat vjetore të monitorimit të gjetisë;
- f) harton planin e menaxhimit të zonave të gjetisë;
- g) miraton planin vjetor të përdorimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjetie, të propozuar nga menaxhuesi i zonës së gjetisë;
- gj) bashkëpunon me shoqatat dhe federatat që operojnë në fushën e gjetisë.

Neni 21

Menaxhuesi i zonës së gjetisë

1. Menaxhuesi i zonës së gjetisë është personi fizik ose juridik, që përzgjidhet sipas një procedure konkurrimi për marrjen në përdorim të një zone gjetie. Kriteret për të përzgjedhur menaxhuesin e zonës së gjetisë janë sipas përcaktimit të pikës 3 të nenit 27 të këtij ligji.

2. Menaxhuesi i zonave të gjetisë, në përmbushje të rolit të tij, ka këto përgjegjësi:

- a) siguron funksionimin e shërbimit profesional për zbatimin e planit të menaxhimit të gjetisë dhe shërbimin e ruajtjes së gjahut;
- b) vendos tabela informuese në terren të zonës së gjetisë dhe informon nëpërmjet afishimit gjetarët për:

- i. kohën e hapjes së sezonit të gjetisë;
- ii. listën e llojeve të faunës së egër, të cilat nuk janë objekt gjetie në Republikën e Shqipërisë dhe ato për të cilat lejohet gjetia;
- iii. llojin e armëve me të cilat kryhet gjetia;
- iv. kundërvajtjet administrative, të cilat dënohen me dënim kryesor me gjobë.
- c) organizon veprimtaritë e gjetisë;
- ç) zbaton planin e menaxhimit;
- d) harton planin vjetor të përdorimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjetie, bazuar në planin e menaxhimit të asaj zone.

Neni 22

Shoqata dhe federatat që operojnë në fushën e gjetisë

1. Shoqatat dhe/apo federatat që operojnë në fushën e gjetisë, krahas detyrave statutore, kryejnë edhe detyrat e mëposhtme:

- a) administrojnë regjistrin e anëtarëve të vet;
- b) marrin pjesë në testimin e gjetarëve;
- c) japin mendim pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore për krijimin e zonave të gjetisë;
- ç) marrin pjesë aktive në përpunimin e politikave, të planeve të menaxhimit e të projekteve për gjetinë;
- d) organizojnë trajnime për të respektuar manualin e gjetarit;
- dh) organizojnë kurse përgatitore për trajnimin e gjetarëve.

2. Shoqatat dhe federatat që operojnë në fushën e gjetisë, në funksion të detyrave sipas pikës 1 të këtij neni, bashkëpunojnë me strukturën përgjegjëse që mbulon natyrën dhe biodiversitetin në njësinë e vetëqeverisjes vendore dhe organizatat mjedisore, me qëllim menaxhimin e qëndrueshëm të gjetisë, ruajtjen e ekosistemeve dhe pasurimin e burimeve të gjetisë, mbrojtjen e mjedisit, kultivimin e etikës së gjetarit dhe ruajtjen e traditave të gjetisë.

KREU V

MENAXHIMI I GJETISË

Neni 23

Dokumentet bazë të menaxhimit të gjetisë

Menaxhimi i zonave të gjetisë dhe i llojeve të faunës së egër, objekt gjetie, kryhet në bazë të:



a) programit kombëtar të zhvillimit të gjetisë, i cili hartohet në përputhje edhe me planet ndërkombëtare të menaxhimit për speciet, objekt gjetie, që ndodhen në një status të pafavorshëm ruajtjeje;

b) planit menaxhues të secilës zonë gjetie;

c) planit vjetor të përdorimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjetie.

Neni 24

Programi kombëtar i zhvillimit të gjetisë

1. Programi kombëtar i zhvillimit të gjetisë pasqyron synimet dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të gjetisë, metodat e rrugët për arritjen e tyre dhe hartohet edhe në përputhje me planet ndërkombëtare të menaxhimit për speciet, objekt gjetie, që ndodhen në një status të pafavorshëm ruajtjeje.

2. Programi hartohet nga ministria për një periudhë 10-vjeçare dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit, dhe përmban:

a) synimet e politikave shtetërore për gjetinë;

b) kërkesat e zhvillimit të qëndrueshëm të gjetisë;

c) rrjetin e zonave të gjetisë në shkallë vendi;

ç) llojet e faunës së egër, objekt gjetie;

d) kuotat e përafërta vjetore të gjuajtjes për çdo lloj të faunës së egër, objekt gjetie.

3. Ministria, gjatë përgatitjes së këtij programi, këshillohet me ministrinë e linjës, Këshillin Kombëtar të Faunës, institucionet e arsimit të lartë e kërkimore-shkencore, si dhe siguron që programi të jetë në përputhje me planet e zhvillimit të territorit dhe me kërkesat e dokumenteve ndërkombëtare të kësaj fushe, ku vendi ynë është palë.

4. Ministria, brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përgatit programin e parë kombëtar të zhvillimit të gjetisë. Pas miratimit programi kombëtar i zhvillimit të gjetisë publikohet në faqen zyrtare të ministrisë.

Neni 25

Plani i menaxhimit të zonës së gjetisë

1. Plani i menaxhimit ka vlefshmëri për një periudhë 10-vjeçare dhe hartohet nga njësia përgjegjëse që mbulon natyrën e biodiversitetin pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, në

bashkëpunim me specialistë të fushës. Plani i menaxhimit miratohet nga ministri dhe shoqërohet me miratimin paraprak të këshillit bashkiak, në rast se zona është në administrim apo në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

2. Plani i menaxhimit përfshin:

a) përshkrimin e zonës së gjetisë;

b) speciet, objekt gjetie të zonës;

c) periudhën kohore të vlefshmërisë së planit;

ç) përshkrimin e përgjithshëm të synimeve dhe objektive të menaxhimit të faunës së egër, përfshirë ndikimin në speciet që nuk janë objekt gjetie;

d) përshkrimin e llojeve të habitateve;

dh) përshkrimin e përmbledhur të historikut të përdorimit të tokës, transformimit të habitatit dhe të menaxhimit të faunës së egër;

e) të dhënat sasiore të shfrytëzimit të faunës së egër, kur këto të dhëna janë të disponueshme;

ë) metodat e miratuara të studimit të zonës, me qëllim përcaktimin e dendësisë së popullatave dhe metodat e monitorimit;

f) metodën e miratuar për përcaktimin e niveleve të shfrytëzimit;

g) rekomandimet për ruajtjen e habitatit për speciet përkatëse.

3. Në hartimin e planit të menaxhimit të zonës mbahen në konsideratë Programi Kombëtar i Zhvillimit të Gjetisë, planet e mbarështimit të pyjeve e kullotave, tokat bujqësore me kushtet e mënyrën e shfrytëzimit të tyre dhe planet e rregullimit të territorit.

4. Plani i menaxhimit rishikohet me kërkesë të menaxhuesit të zonës së gjetisë ose të njësisë përgjegjëse që mbulon natyrën dhe biodiversitetin pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, kur ka ndryshime thelbësore të kushteve e të rrethanave, për të cilat është dhënë zona e gjetisë.

Neni 26

Plani vjetor i përdorimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjetie

1. Përpara çeljes së sezonit të gjetisë, menaxhuesit e zonave të gjetisë hartojnë planin vjetor të përdorimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjetie, pa të cilin gjetia nuk mund të ushtrohet në asnjë zonë.

2. Plani vjetor përmban veprimet konkrete të menaxhuesit të zonës së gjetisë për:



a) përlogaritjet e përafërta për fondin, për kapacitetin e zonës, për mundësinë e gjuajtjes;

b) shtimin e popullatës së llojeve, objekt gjuetie;

c) ndërtimet në dobi të llojeve të faunës së egër, si mjedise për të pirë ujë e çerdhe;

ç) mbjellje bimësh e sigurim ushqimi për llojet e egra në periudha të vështira;

d) ndërtime në dobi të gjuetarëve, si pika vëzhgimi e ngrehina të thjeshta për ndenjie;

dh) vendosje shenjash të kufijve, mirëmbajtje rrugësh e shtigjesh për gjuetarët.

3. Plan miratohet nga njësia përgjegjëse që mbulon natyrën dhe biodiversitetin në njësinë së vetëqeverisjes vendore përkatëse, brenda 10 ditëve nga hartimi i tij. Miratimi i planit të zonës bëhet të paktën një muaj para çeljes së sezonit të gjuetisë.

4. Menaxhuesi i zonës së gjuetisë çdo vit raporton te njësia përgjegjëse që mbulon natyrën dhe biodiversitetin pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse dhe/apo pronari i zonës për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga plani vjetor.

5. Nëse, për shkak të fatkeqësive natyrore ose të rasteve të tjera emergjente, nuk zbatohet plani vjetor i menaxhimit, menaxhuesi i zonës së gjuetisë njofton menjëherë njësinë përgjegjëse që mbulon natyrën dhe biodiversitetin pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse.

6. Metodikat e hartimit të planeve të menaxhimit të zonave të gjuetisë dhe planeve vjetore të përdorimit, si dhe procedurat e miratimit të tyre, përcaktohen me udhëzimin e ministrit.

KREU VI

DHËNIA NË PËRDORIM E ZONËS TË GJUE TISË

Neni 27

Dhënia në përdorim e zonave të gjuetisë, mbarështimit dhe ripopullimit

1. Zonat e gjuetisë, të mbarështimit e të ripopullimit i jepen në përdorim me kontratë qiraje menaxhuesit të zonës së gjuetisë nëpërmjet procedurës së konkurrimit publik dhe kushteve e kriterëve të parashikuara në këtë ligj.

2. Dhënia në përdorim bëhet me kontratë qiraje për një afat deri në 5 vjet, me të drejtë rinovimi. Kontrata nuk rinovohet në rast të heqjes apo

ndryshimit të statusit të zonës së gjuetisë, sipas parashikimeve të nenit 12 të këtij ligji.

3. Kriteret për marrjen në përdorim të zonës së gjuetisë janë:

a) kur menaxhuesi i zonës së gjuetisë është person fizik duhet:

i. të jetë i regjistruar si person fizik tregtar;

ii. të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale në fushën e mjedisit, si dhe për ato që cenojnë jetën dhe shëndetin e njeriut;

iii. të ketë shlyer të gjitha detyrimet tatimore qendrore dhe detyrimet vendore;

iv. të ketë një plan biznesi për menaxhimin e zonës së gjuetisë, duke përfshirë kushtet minimale dhe kërkesat e sigurisë, si dhe investimet që do të bëjnë në zonë.

b) kur menaxhuesi i zonës së gjuetisë është person juridik, tregtar apo organizatë jofitimprurëse, përveç kriterëve të parashikuara në nënparagrafët “iii” dhe “iv” të pikës 3 të këtij neni, duhet:

i. të jetë i regjistruar si person juridik;

ii. që administratori apo drejtuesi i organit më të lartë vendimmarrës apo anëtarët e tij të mos jenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale në fushën e mjedisit, si dhe për ato që cenojnë jetën dhe shëndetin e njeriut.

4. Dokumentacioni, afatet dhe procedura e konkurrimit për dhënien me qira të zonës së gjuetisë, mbarështimit dhe ripopullimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

5. Për çdo rast të dhënies me qira të zonës së gjuetisë, mbarështimit dhe ripopullimit njoftohet ministria përgjegjëse për gjuetinë.

6. Në rastin kur zona e miratuar e gjuetisë, mbarështimit dhe ripopullimit është pronë private, procedura e dhënies në përdorim me kontratë qiraje bëhet sipas parashikimeve të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të këtij ligji, si dhe njoftohet njësia përgjegjëse që mbulon natyrën dhe biodiversitetin pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Neni 28

Vlera fillestare për qiranë

1. Vlera fillestare për qiranë e zonës së gjuetisë përcaktohet sa 50 për qind e vlerës së gjuetisë vjetore të kafshëve të egra, të planifikuara sipas planit të



menaxhimit të zonës së gjuetisë, të llogaritura sipas çmimit të tregut.

2. Vlera fillestare për qiranë e zonës së gjuetisë shërben si çmim dysheme për subjektet, që do të marrin pjesë në konkurrimin publik.

3. Përjashtimisht, deri në miratimin e planit të menaxhimit të zonës së gjuetisë, vlera fillestare e parashikuar në pikën 1 të këtij neni përcaktohet në bazë të inventarit të vitit paraardhës të kafshëve të egra, të ndodhura në zonën e gjuetisë për të cilën zhvillohet procedura e konkurrimin.

Neni 29

Kontrata e qirasë

1. Njësia e vetëqeverisjes vendore lidh me fituesin kontratë për dhënien me qira të zonës së gjuetisë, e cila duhet të përmbajë të paktën:

- a) emërtimin, sipërfaqen, kufijtë dhe infrastrukturën e zonës së gjuetisë;
- b) llojin dhe numrin e përafërt të kafshëve të egra, objekt gjuetie;
- c) masat për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e zonës së gjuetisë;
- d) detyrimet për të investuar në zonë;
- e) mënyrën, shumën dhe afatin e pagesës së qirasë.

2. Kontrata e qirasë lidhet brenda 30 ditëve nga shpallja e fituesit, por jo më vonë se fillimi i sezonit të gjuetisë.

Neni 30

Zgjidhja e parakohshme e kontratës së qirasë

1. Kontrata e qirasë mund të zgjidhet para përfundimit të afatit me marrëveshje midis palëve, si dhe në rastet kur:

- a) zona e gjuetisë humbet tërësisht ose dëmtohet për shkak të një force madhore, aq sa nuk mund të ushtrohet veprimtaria e gjuetisë apo zona e humb statusin, sipas parashikimeve të nenit 12 të këtij ligji;
- b) njësia e vetëqeverisjes vendore nuk i siguron menaxhuesit të zonës së gjuetisë gëzimin e plotë të zonës së gjuetisë, të marrë në përdorim nga menaxhuesi, për shkak të forcës madhore;
- c) janë shkelur dhe nuk janë respektuar kushtet e kontratës nga menaxhuesi i zonës së gjuetisë dhe/ose njësia e vetëqeverisjes vendore;
- d) menaxhuesi i zonës së gjuetisë:

i. nuk e përdor zonën e gjuetisë, në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe me kushtet e kontratës së qirasë për përdorimin e zonës, për gjueti.

ii. nuk zbaton masat e parashikuara në planin e menaxhimit e, për rrjedhojë, fondi i kafshëve të egra bie nën minimumin e parashikuar në këtë plan;

iii. nuk realizon investimet e parashikuara në zonën e gjuetisë dhe nuk e shfrytëzon atë për qëllimin për të cilin është lidhur kontrata;

iv. nuk e paguan qiranë për dy periudha radhazi në masën dhe në afatin e parashikuar në kontratë.

2. Në rastet e zgjidhjes së parakohshme të kontratës së qirasë, njësia e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet specialistëve të fushës së faunës, konstaton gjendjen faktike të zonës së gjuetisë e të zbatimit të planit të saj menaxhues. Menaxhuesi i zonës së gjuetisë detyrohet të bëjë kompensimin e dëmit real, të shkaktuar në zonë, sipas çmimeve të tregut.

3. Përcaktimi i vlerës reale të dëmit bëhet me akt ekspertimi, të hartuar nga specialistë të fushës së faunës, të pranuar nga të dyja palët kontraktuese ose të vendosur nga gjykata në rastet kur palët nuk bien dakord.

4. Kontrata e qirasë mund të zgjidhet nga njësia e vetëqeverisjes vendore edhe për shkaqe të interesit publik. Në këtë rast menaxhuesi i zonës së gjuetisë ka të drejtën e rimbursimit nga njësia e vetëqeverisjes vendore për afatin e mbetur.

5. Menaxhuesi i zonës së gjuetisë nuk ka të drejtë rimbursimi në rastet kur kontrata zgjidhet për shkaqet e parashikuara në shkronjën “ç” të pikës 1 të këtij neni.

6. Në të gjitha rastet e zgjidhjes së parakohshme të kontratës së qirasë, të parashikuara në shkronjat “c” dhe “ç” të pikës 1 të këtij neni, zhvillohet procedura e re e konkurrimin publik për dhënien e zonës së gjuetisë në përdorim. Deri në dhënien e saj në përdorim, gjuetia ndalohe, ndërsa masat e kultivimit dhe të mbrojtjes së kafshëve të egra i merr pronari i zonës ose personi i autorizuar prej tij.

KREU VII

USHTRIMI I GJUEËTISË

Neni 31

Sezoni i gjuetisë

1. Gjuetia ushtrohet vetëm brenda sezonit të hapur për gjueti, duke respektuar periudhën e



riprodhimit, derisa të vegjlit të ndahen nga nëna, si dhe periudhën e foljezimit, derisa të vegjlit të mësojnë të fluturojnë. Sezoni i hapur për gjueti përcaktohet sipas kriterëve gjeografike, klimatike dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për gjuetinë. Për çdo vit ministria publikon hapjen e sezonit të gjuetisë në faqen e saj zyrtare.

2. Kohëzgjatja e gjuetisë sipas llojeve, si dhe ditët e lejuara për gjueti, brenda sezonit të gjuetisë, caktohen me urdhër të ministrit.

3. Dita e gjuetisë fillon pas lindjes së diellit dhe përfundon me perëndimin e tij.

Neni 32

Pagesat për ushtrimin e gjuetisë

1. Për ushtrimin e gjuetisë gjuetari bën pagesën, e cila përfshin:

- a) tarifën e lejes së gjuetisë;
- b) tarifën për përdorimin e zonës së gjuetisë;
- c) pagesën për çdo individ të vrarë të llojeve objekt gjuetie.

2. Tarifat e parashikuara në shkronjat “a” dhe “c” të pikës 1 të këtij neni dhe mënyra e pagesës së tyre miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për gjuetinë.

3. Tarifa e parashikuar në shkronjën “b” të pikës 1 përcaktohet nga menaxhuesi i zonës, duke mbajtur në konsideratë tarifën e përcaktuara në planin e biznesit, në bazë të të cilit ka përfituar menaxhimin e zonës.

Neni 33

Gjuetari

Gjuetar është individ i cili plotëson kriteret e mëposhtme:

- a) të jetë shtetas shqiptar apo shtetas i huaj, në përputhje me parashikimet e shkronjës “d” të nenit 40 të ligjit nr. 74/2014 “Për armët”, të ndryshuar;
- b) të ketë mbushur moshën 25 vjeç;
- c) të jetë i pajisur me autorizim për mbajtje armë gjahu;
- ç) të jetë pajisur me certifikatën e gjuetarit, sipas parashikimeve në nenin 34 të këtij ligji;
- d) të jetë pajisur me leje gjuetie;
- dh) të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale në fushën e mjedisit, si dhe për ato që cenojnë jetën dhe shëndetin e njeriut;

e) të jetë anëtar i një shoqate apo federate që operon në fushën e gjuetisë;

ë) të jetë i pajisur me kontratë sigurimi për përgjegjësinë civile ndaj palëve të treta, që rrjedh nga përdorimi i armëve ose mjeteve të dobishme për ushtrimin e aktivitetit të gjuetisë.

Neni 34

Testimi i gjuetarit

1. Personat që kërkojnë të ushtrojnë gjuetinë i nënshtrohen testimit të gjuetarit, të organizuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

2. Testimi i gjuetarit bazohet në manualin e gjuetarit, të miratuar nga ministria përgjegjëse për gjuetinë. Manuali hartohet nga ministria përgjegjëse për gjuetinë, në bashkëpunim me shoqatat dhe federatat e gjuetarëve, me institucionet e arsimit të lartë që ofrojnë programe studimi në fushën e biologjisë, si dhe me Këshillin Kombëtar të Faunës.

Manuali përmban njohuri teorike e praktike për:

- a) veprimtarinë e gjuetisë dhe legjislacionin që e rregullon atë;
- b) menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të llojeve, objekt gjuetie;
- c) biologjinë dhe karakteristikat e llojeve të faunës së egër;
- ç) mënyrat, metodat dhe mjetet e lejuara të gjuetisë;
- d) armët e gjuetisë dhe përdorimin e tyre;
- dh) qentë e gjuetisë dhe rolin e tyre në veprimtarinë e gjuetisë;
- e) sëmundjet e llojeve, objekt gjuetie, si dhe masat për parandalimin e tyre.

3. Për organizimin e testimit të gjuetarit krijohet një komision i posaçëm, që funksionon në bazë qarku, me përbërje nga njësia e vetëqeverisjes vendore, nga ministria përgjegjëse për gjuetinë, nga shoqatat e federatat që operojnë në fushën e gjuetisë dhe kryesohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore që ka shtrirjen më të madhe.

4. Personat që marrin minimalisht 70% të pikëve në testimin e gjuetarit fitojnë të drejtën të pajisen me certifikatën e gjuetarit.

5. Format i certifikatës miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për gjuetinë.



Neni 35

Kërkesa për t'u pajisur me leje gjuetie

1. Personat e pajisur me certifikatë gjuetari aplikojnë me kërkesë për leje gjuetie në portalin qeveritar “e-Albania” dhe ngarkojnë dokumentet e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.

2. Kërkesa përmban gjeneralitetet e kërkuesit, zonën ku do të ushtrojë gjuetinë dhe kohëzgjatjen e ushtrimit të saj.

3. Dokumentacioni, që ngarkohet nga aplikuesi në portalin “e-Albania” është si më poshtë:

- a) certifikata e gjuetarit;
- b) autorizimi për mbajtjen e armës së gjahut;
- c) një fotografi me përmasa 4x6 ;
- ç) mandatpagesa e tarifës së lejes.

4. Njësia përgjegjëse që mbulon natyrën dhe biodiversitetin pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore e shqyrton kërkesën së bashku me dokumentet sipas pikës 3 dhe brenda 7 ditëve njofton aplikuesin nëpërmjet portalit “e-Albania” për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm në rast konstatimi të pasaktësive apo të mungesës së dokumentacionit. Aplikuesi plotëson dokumentacionin e nevojshëm brenda 5 ditëve pune nga data e marrjes së njoftimit.

5. Në rast se aplikuesi nuk plotëson dokumentacionin brenda afatit të kërkuar, kërkesa konsiderohet si e paregjistruar dhe i kthehet aplikuesit bashkë me aktet e tjera nëpërmjet portalit “e-Albania”.

6. Kur aplikuesi i plotëson kriteret dhe dokumentacioni i paraqitur rezulton i plotë, njësia përgjegjëse për natyrën dhe biodiversitetin në njësinë e vetëqeverisjes vendore njofton menjëherë aplikuesin nëpërmjet portalit “e-Albania” për lëshimin e lejes së gjuetisë, jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së vendimit.

7. Në rast refuzimi të kërkesës për pajisje me leje gjuetie, aplikuesi ka të drejtën e ankimit te titullari i njësisë së vetëqeverisjes vendore brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit të vendimit. Pas përfundimit të këtij afati aplikuesi ka të drejtën e ankimit në gjykatën administrative kompetente brenda 45 ditëve nga data e marrjes dijeni të vendimit.

Neni 36

Leja e gjuetisë

1. Leja e gjuetisë është dokumenti që i njeh të drejtën e ushtrimit të gjuetisë personit, që plotëson kushtet dhe kërkesat e këtij ligji. Format i lejes së gjuetisë miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për gjuetinë.

2. Leja e gjuetisë përmban:

a) zonën ku lejohet të ushtrohet gjuetia:

i. në të gjitha zonat e miratuara për gjueti të vendit;

ii. në të gjitha zonat për gjueti të qarkut ku banon gjuetari.

b) kohën kur do të ushtrohet gjuetia. Leja e gjuetisë jepet për një afat 5-vjeçar ose për një sezon gjuetie, në përputhje me kërkesën e gjuetarit;

c) listën e specieve, objekt gjuetie, në varësi të statusit, të favorshëm ose të pafavorshëm të ruajtjes së një lloji në zonën përkatëse të gjuetisë.

3. Leja e gjuetisë është personale dhe e patransferueshme. Ajo mbahet nga gjuetari sa herë që ai shkon për gjueti dhe u paraqitet organeve të kontrollit kur e kërkojnë.

4. Është i ndaluar çdo lloj aktiviteti gjuetie pa lejen e vlefshme të gjuetisë.

Neni 37

Regjistri i lejeve të gjuetisë

1. Njësitë përgjegjëse për gjuetinë të njësive të vetëqeverisjes vendore administrojnë regjistrin e lejeve të gjuetisë, sipas formatit të miratuar, me urdhër të ministrit përgjegjës për gjuetinë.

2. Në regjistrin e lejeve të gjuetisë shënohen leja e dhënë, emri dhe mbiemri i personit të cilit i është dhënë leja, kohëzgjatja e saj, zona ku ushtrohet, ndëshkimet eventuale të dhëna për mbajtësin e saj gjatë sezonit të gjuetisë dhe heqja e lejes.

3. Regjistri i lejeve të gjuetisë publikohet në faqen e internetit të njësisë përgjegjëse për gjuetinë të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe është i hapur për publikun.

Neni 38

Heqja e lejes së gjuetisë

1. Leja e gjuetisë hiqet nga njësia e vetëqeverisjes vendore që e ka lëshuar atë në çdo kohë, kur mbajtësi i saj:



a) bëhet nga ana shëndetësore i paaftë për të ushtruar gjuetinë;

b) ka paraqitur dokumente apo të dhëna të falsifikuara për kërkimin e lejes;

c) është ndëshkuar me masë administrative më shumë se dy herë;

ç) është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale në fushën e mjedisit, si dhe për ato që cenojnë jetën dhe shëndetin e njeriut.

d) ia jep lejen një personi tjetër për ta përdorur;

dh) ka shkelur më shumë se dy herë kushtet e lejes së gjuetisë.

2. Ndaj vendimit për heqjen e lejes së gjuetisë gjuetari mund ta paraqesë ankimin pranë titullarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit të vendimit. Pas kalimit të këtij afati gjuetari ka të drejtën e ankimit në gjykatën për çështjet administrative brenda 45 ditëve nga data e marrjes dijeni të vendimit.

Neni 39

Metoda, teknika dhe mjete të ndaluara në gjueti

1. Është e ndaluar vrasja apo zënia e individëve të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, duke përdorur mjete e metoda të zënies ose të vrasjes në shkallë të gjerë dhe në mënyrë joselektive, si:

a) helm dhe karrem helmues ose trullësës;

b) me mjete dhe metoda që shkaktojnë shkatërrim masiv, duke përdorur kafshë të gjalla, të verbra ose të gjymtuara si karrem;

c) përdorimi i kurtheve me ledha e futjen e lëkurave/gëzofëve dhe mallrave të përpunuara të disa llojeve të kafshëve të egra me origjinë nga vende, të cilat i kapin ato me anë të kurtheve, kapjes ose metodave që nuk plotësojnë standardet ndërkombëtare njerëzore të kurthit/kapjes;

ç) eksplozivë, kurthe, gropa, gracka, ngjitës për shpendë, grepa, rrjeta, karrem të helmuar ose mjete mashtruese;

d) kuaj, qerre, automjete, barka me motor, që lundrojnë me shpejtësi mbi 5 km/orë ose aeroplan për ndjekje;

dh) drita artificiale ose pasqyra ndriçuese;

e) pajisje elektronike për të përmirësuar pamjen në dritë të dobët;

ë) pajisje elektrike dhe elektronike për vrasje ose trullësje me pajisje ndriçimi artificiale, me pasqyra dhe pajisje të tjera verbuese;

f) pajisje ndriçimi të shënjestrës;

g) pajisje për imitim të zërit, si dhe çdo pajisje tjetër imituese/ndjellëse;

gj) rrymë elektrike për të vrarë ose paralizuar;

h) tym ose gaz, që i detyrojnë kafshët të dalin nga vendet ku fshihen;

i) rrjeta për kapjen e shpendëve;

j) armë automatike ose gjysmautamatike;

k) përdorim të municioneve të gjuetisë me përbërje plumbi në ato ligatina, të cilat janë jashtë territorit të zonave të mbrojtura.

2. Gjuetari përdor qentë për ndjekjen e kafshës së plagosur, por nuk i lejon ata që ta mundojnë atë.

3. Gjuetarët që plagosin gjitarë të mëdhenj i ndjekin gjurmët e kafshës së plagosur e, nëse është e nevojshme, njoftojnë menaxhuesin e zonës më të afërt të gjuetisë.

Neni 40

Veprime të ndaluara në gjueti

1. Në territorin e Republikës së Shqipërisë ndalohet:

a) gjuetia pa qenë i pajisur me leje gjuetie;

b) gjuetia e kafshëve dhe e shpendëve të egër që nuk janë në listën e llojeve objekt gjuetie;

c) gjuetia jashtë zonave të gjuetisë;

ç) ushtrimi i gjuetisë në periudhën e ndaluar dhe jashtë sezonit për gjueti;

d) ushtrimi i gjuetisë me mjete, mënyra e metoda që ndalohen nga ky ligj dhe nga aktet nënligjore, në zbatim të tij;

dh) vrasja e shpendëve në kohën kur u bien pendët, kur kanë ngrirë nga të ftohtit, kur janë të prekur nga sëmundje epidemike, zoonotike, si dhe kapja e kafshëve gjatë përmytjeve;

e) ushtrimi i gjuetisë në raste përmytjesh, borë mbi 40 cm, ngricash, zjarri ose kushteve të tjera të jashtëzakonshme natyrore, që vështirësojnë dukshëm lëvizjen e kafshëve;

ë) prishja e çerdheve, dëmtimi, mbledhja, marrja e vezëve dhe e të porsalindurve, vrasja ose nxjerrja nga strofka dhe shfarosja e atyre që ndodhen në të;

f) vrasja e gjahut në kohën e riprodhimit dhe të rritjes së të vegjëlve;

g) gjuetia gjatë periudhës së shumimit apo të kujdesit për të vegjlit dhe për llojet migratore gjatë kthimit të tyre në territoret e shumimit;

gj) vrasja ose kapja e individëve të llojeve, objekt gjuetie, mbi sasi të lejuara;



h) gjuajtja gjatë natës, duke filluar me perëndimin e diellit deri në lindjen e tij;

i) dëmtimi i rrethimeve, i ndërtimeve për gjuetinë, i vendeve të gjuetisë, i tabelave e shenjave të kufijve, i kullave të vrojtimit dhe i kafazeve të vendosura për zogjtë;

j) tregtimi i specieve të gjalla ose të ngordhura për të cilat gjuetia dhe kurrthet nuk lejohen, përveç me një autorizim specifik të ministrisë;

k) gjuajtja nga makina, nga mjetet e lundrimit dhe nga mjetet e fluturimit;

l) mbajtja dhe transportimi i armëve të gjuetisë me fishek në fole gati për qitje, të karikuara, të pavëna në siguresë dhe pa leje të vlefshme gjuetie, në lëvizje dhe në qendra të banuara;

2. Kapja, vrasja ose shfarosja e llojeve të shpendit të shqiponjës dhe popullatave të tyre, duke përfshirë vezët e tyre, është e ndaluar në Republikën e Shqipërisë.

3. Kapja, vrasja ose shfarosja e faunës së egër dhe popullatave të tyre, duke përfshirë vezët e tyre, është e ndaluar:

a) në zonat e mbarështimit;

b) gjatë periudhës së mbylljes së sezonit të gjuetisë;

c) gjatë periudhave të ndalimit të përkohshëm të gjuetisë;

ç) në zonat e ndaluara për gjueti;

d) në kundërshtim me planin e menaxhimit të parashikuar në nenin 25 të këtij ligji;

dh) përjashtohet ndalimi sipas përcaktimeve të këtij neni, vetëm nëse nevojiten masa të menjëhershme, në kuadër të kontrollit dhe çrrënjësjes së sëmundjeve infektive dhe zoonotike.

4. Fauna e egër, e kapur ose e vrarë, duke përfshirë vezët e tyre, në kundërshtim me parashikimet e pikës 2 të këtij neni, konfiskohet nga:

a) njësia përgjegjëse që mbulon natyrën dhe biodiversitetin pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, në rastet kur shkelja ndodh jashtë zonave të gjuetisë;

b) menaxhuesi i zonës së gjuetisë, në rastin kur shkelja ndodh brenda zonës së gjuetisë.

Neni 41

Armët e gjuetisë

1. Gjuetia lejohet të kryhet vetëm me armë gjahu, me leje të prodhuara për këtë qëllim, dhe që

plotësojnë kërkesat teknike të sigurisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për armët.

2. Rregullat e mbajtjes, ruajtjes dhe përdorimit të armës së gjahut me leje gjatë gjuetisë dhe në çdo kohë e vend tjetër miratohen me udhëzimin e përbashkët të ministrit dhe të ministrit të Brendshëm, duke mbajtur në konsideratë edhe legjislacionin në fuqi për armët.

3. Gjuetari i pajisur me autorizim për mbajtje armë gjahu, sipas parashikimeve të këtij ligji, ka të drejtë të mbajë edhe thika dhe mjete të mprehta, të domosdoshme për gjueti, të konsideruara armë të ftohta, duke respektuar përcaktimet e legjislacionit në fuqi për armët.

Neni 42

Deklarimi i gjahut

1. Në përfundim të ditës së gjuetisë, gjuetari deklaron te menaxhuesi i zonës së gjuetisë numrin e kafshëve e të shpendëve të vrara, i cili i matrikulon dhe i regjistron ato.

2. Në rast se gjahu ka shenja sëmundjeje, është e ndaluar nxjerrja e tij nga zona e gjuetisë. Gjuetari njofton menjëherë menaxhuesin dhe shërbimin veterinar më të afërt për ndjekjen e protokollit përkatës, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 43

Pronësia e gjahut

Gjahu i vrarë gjatë ushtrimit të gjuetisë i përket gjuetarit që e ka vrarë atë.

Neni 44

Trofetë e gjuetisë

1. Trofetë e gjuetisë vlerësohen nga komisioni i vlerësimit të trofeve, që krijohet me urdhër të ministrit.

2. Komisioni i vlerësimit të trofeve përbëhet nga 7 anëtarë, të cilët propozohen nga shoqatat dhe federatat që operojnë në fushën e gjuetisë, institucionet e arsimit të lartë që ofrojnë programe studimi në fushën e biologjisë dhe nga ministria përgjegjëse për gjuetinë.

3. Komisioni i vlerësimit të trofeve vepron pranë ministrisë për një afat 10-vjeçar. Ai mblidhet sa herë paraqiten kërkesa për shqyrtim dhe e shqyrton



secilën brenda 30 ditëve nga regjistrimi i saj në protokoll.

4. Për vlerësimin e trofeve të gjetisë, kërkuesi paguan një tarifë prej 5 000 (pesë mijë) lekësh.

5. Organizimi dhe funksionimi i komisionit të vlerësimit të trofeve dhe dokumentet që ai administron përcaktohen në rregulloren e miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për gjetinë.

Neni 45

Tregtimi i gjahut

1. Gjetari mund të tregtojë te personat fizikë dhe juridikë individë të vrarë të llojeve të faunës së egër, objekt gjetie, pjesë të tyre dhe trofe nga gjetia, të siguruar në mënyrë të ligjshme, kur ato figurojnë të matrikuara nga menaxhuesi i zonës, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për veterinarinë dhe sigurinë ushqimore.

2. Është i ndaluar tregtimi i individëve të vrarë të llojeve të faunës së egër, lëkurave, trofeve dhe të mirave të prodhuara prej tyre, që nuk janë objekt gjetie sipas listës së miratuar me udhëzim të ministrit, si dhe të specieve të mbrojtura apo të pa matrikuara.

3. Mosrespektimi i pikës 2 të këtij neni përbën shkelje administrative ose penale, sipas rastit, dhe objektet konfiskohen nga struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e gjetisë.

KREU VIII

MONITORIMI DHE KONTROLLI

Neni 46

Monitorimi i gjetisë

1. Monitorimi i gjetisë është proces i detyrueshëm, që kryhet nga menaxhuesi i zonës së gjetisë, nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e strukturës përgjegjëse që mbulon natyrën dhe biodiversitetin pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore.

2. Programet e monitorimit dhe zbatimi i tyre kryhen nga njësia përgjegjëse që mbulon natyrën dhe biodiversitetin pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim me menaxhuesin e zonës së gjetisë, dhe përcaktojnë metodat e grumbullimit të të dhënave për llojet, objekt gjetie, dhe të përpunimit të tyre.

3. Monitorimi i gjetisë, si pjesë përbërëse e monitorimit të faunës së egër, përmbledh

monitorimin e veprimtarisë së gjetisë dhe monitorimin e zonave të gjetisë.

4. Të dhënat vjetore të monitorimit të zonave të gjetisë mbledhen në nivel qarku nga njësia përgjegjëse që mbulon natyrën dhe biodiversitetin pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, e cila ia dërgon ato strukturës përgjegjëse për gjetinë në ministri brenda muajit maj për vitin paraardhës. Struktura përgjegjëse për natyrën dhe biodiversitetin në ministri i përpunon të dhënat e grumbulluara dhe rezultatet i publikon brenda muajit qershor në faqen e saj zyrtare.

Neni 47

Inventarizimi i llojeve, objekt gjetie

1. Popullatat e llojeve, objekt gjetie, inventarizohen çdo vit në çdo zonë gjetie, për të identifikuar sasinë e tyre, shtesën natyrale vjetore të popullatës së secilit lloj, si dhe për të planifikuar sasinë e individëve që mund të gjuhen gjatë sezonit të ardhshëm në zonën konkrete. Në sezonin e ardhshëm nuk mund të planifikohen për t'u gjuajtur më shumë se 10 për qind të shtesës natyrale të popullatës së llojit.

2. Inventarizimi dhe regjistrimi i llojeve dhe popullatave të tyre kryhen nga menaxhuesi i zonës së gjetisë, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse që mbulon natyrën dhe biodiversitetin pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, si dhe specialistët në fushën e faunës, duke mbajtur parasysh kërkesat e veçanta të çdo lloji.

3. Menaxhuesit e zonave të gjetisë, krahas grumbullimit të të dhënave për numrin e kafshëve të egra, brenda zonës, grumbullojnë edhe të dhëna të tjera për gjendjen e kushtet e jetesës së kafshëve në zonën e gjetisë dhe shënimet i dërgojnë në njësinë përgjegjëse që mbulon natyrën dhe biodiversitetin pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse, e cila mban regjistrin e kafshëve të egra të zonave të gjetisë.

4. Metodika e regjistrimit dhe inventarizimit të llojeve dhe popullatave të tyre, si dhe dokumentet e formatuara ku pasqyrohen të dhënat dhe rezultatet e inventarizimit të llojeve, objekt gjetie, miratohen me udhëzimin e ministrit.



Neni 48

Kontrolli dhe inspektimi mbi gjuetinë

1. Kontrolli dhe inspektimi për gjuetinë kryhen nga struktura përgjegjëse që mbulon natyrën dhe biodiversitetin pranë njësisë të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin.

2. Struktura përgjegjëse që mbulon natyrën dhe biodiversitetin pranë njësisë të vetëqeverisjes vendore bashkëpunon me strukturat e policisë bashkiake, në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe me legjislacionin në fuqi për policinë bashkiake.

3. Për çdo rast të shkeljes së dispozitave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, zbatohen parashikimet e legjislacionit në fuqi për inspektimin, si dhe mbahet një procesverbal që nënshkruhet nga hartuesi, shkelësi dhe dëshmitari i pranishëm dhe, në mungesë të dëshmitarit, procesverbali është i vlefshëm vetëm me nënshkrimin e menaxhuesit të zonës së gjuetisë apo të inspektorit të organeve të kontrollit.

4. Gjahu i vrarë ose i kapur konfiskohet, leja e gjuetisë i merret gjuetarit, armët e mjetet e gjahut sekuestrohen me procesverbal dhe i dorëzohen Policisë së Shtetit. Arma e sekuestruar i kthehet gjuetarit sezonin e ardhshëm pasi ka likuiduar gjobën përkatëse.

5. Masat e parashikuara në pikën 4 të këtij neni përbëjnë masa plotësuese, që mund të jepen krahas dënimit kryesor me gjobë ose ndëshkime të tjera të parashikuara në ligj.

Neni 49

Kontrolli doganor

1. Importi, eksporti, si dhe transiti i faunës së egër, objekt gjuetie, përfshirë edhe produktet e gjuetisë dhe vezët e tyre, i nënshtrohen legjislacionit doganor në fuqi, legjislacionit në fuqi për tregtimin e llojeve të faunës së egër dhe legjislacionit në fuqi për shëndetin e kafshëve.

2. Me përjashtim të pikës 1 të këtij neni, për qëllime shkencore, kërkimore ose edukative, zbatohet legjislacioni në fuqi për tregtimin e llojeve të faunës së egër.

3. Individë të vrarë të llojeve, objekt gjuetie, eksportohen, kur ato shoqërohen me vërtetim nga menaxhuesi i zonës së gjuetisë dhe me raport nga shërbimi veterinar.

4. Autoritetet doganore informohen periodikisht ose rast pas rasti nga një prej strukturave të kreut IV të këtij ligji për rastet dhe periudhat e ndalimeve apo kufizimeve të eksporteve.

KREU IX

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 50

Kundërvajtjet

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me dënim kryesor me gjobë, si më poshtë vijon:

a) gjuetia e kafshëve të egra, që nuk janë në listën e llojeve, objekt gjuetie, sipas pikës 2 të nenit 5, dënohet me gjobë në masën nga 500 000 (pesëqind mijë) lekë deri në 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë;

b) gjuetia në zonat e ndaluara për gjueti nga gjuetari, sipas nenit 8, dënohet me gjobë në masën nga 500 000 (pesëqind mijë) lekë deri në 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë;

c) ushtrimi i gjuetisë në vendet e ndaluara për gjueti nga gjuetari, sipas pikës 1 të nenit 14, dënohet me gjobë në masën nga 200 000 (dyqind mijë) lekë deri në 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë;

ç) ushtrimi i gjuetisë pa pasur me vete lejen e gjuetisë nga gjuetari, sipas pikës 2 të nenit 36, dënohet me gjobë në masën 130 000 (njëqind e tridhjetë mijë) lekë;

d) ushtrimi i gjuetisë pa pasur leje të vlefshme gjuetie nga gjuetari, sipas pikës 3 të nenit 36, dënohet me gjobë në masën 400 000 (katërqind mijë) lekë;

dh) vrasja apo zënia e individëve të llojeve të shqiponjës nga gjuetari dënohet me gjobë në masën 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë;

e) vrasja apo zënia e individëve të llojeve të faunës së egër nga gjuetari dhe/ose menaxhuesi i zonës së gjuetisë, objekt gjuetie, duke përdorur mjete, metoda, teknika dhe mjete të ndaluara në gjueti, sipas pikës 1 të nenit 39, dënohet me gjobë në masën nga 500 000 (pesëqind mijë) lekë deri në 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë;

ë) veprimet e ndaluara në gjueti nga gjuetari dhe/ose menaxhuesi i zonës së gjuetisë, sipas



pikës 1 të nenit 40, dënohen me gjobë në masën nga 400 000 (katërqind mijë) lekë deri në 800 000 (tetëqind mijë) lekë;

f) ushtrimi i gjuetisë me armë nga gjuetari dhe menaxhuesi i zonës së gjuetisë, që nuk lejohen për t'u përdorur si armë gjuetie, sipas pikës 1 të nenit 41, dënohet me gjobë në masën nga 500 000 (pesëqind mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë;

g) mosdeklarimi i gjahut të vrrarë dhe mospagimi i tarifës për çdo individ të vrrarë nga gjuetari dhe/ose menaxhuesi i zonës së gjuetisë, sipas pikës 1 të nenit 42, dënohet me gjobë në masën nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 260 000 (dyqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë;

gj) mosnjoftimi i shërbimit veterinar dhe dalja e gjahut nga zona e gjuetisë nga gjuetari dhe/ose menaxhuesi i zonës së gjuetisë, që dyshohet për sëmundje, sipas pikës 2 të nenit 42, dënohet me gjobë në masën 130 000 (njëqind e tridhjetë mijë) lekë;

h) tregtimi i paligjshëm i lëkurave të kafshëve ose i të mirave të prodhuara prej tyre për llojet e specieve mbrojtura nga individë, sipas pikës 3 të nenit 45, dënohet me gjobë në masën nga 500 000 (pesëqind mijë) lekë deri në 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë.

2. Subjekti ndaj të cilit merret masa e dënimit me gjobë ka të drejtën e paraqitjes së ankimit pranë organit kompetent, bazuar në parashikimet e legjislacionit në fuqi për inspektimin. Shqyrtimi, marrja e vendimit përfundimtar dhe ankimi ndaj tij bëhen në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për inspektimin.

3. Gjoha e vendosur nga inspektori përgjegjës në fushën e gjuetisë, në zbatim të këtij neni, përbën titull ekzekutiv, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, dhe derdhet në buxhetin e shtetit. Gjoha paguhet brenda 10 ditëve kalendarike nga data e njoftimit të vendimit për dënimin me gjobë që përbën titull ekzekutiv. Në rast mosekzekutimi vullnetar, ekzekutimi i gjobës kryhet nga zyra e përmbarimit, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile dhe në ligjin për kundërvajtjet administrative.

KREU X

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 51

Akte nënligjore

Brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji:

a) Këshilli i Ministrave miraton aktet nënligjore në zbatim të pikës 3 të nenit 11; pikave 2 dhe 3 të nenit 12; pikës 3 të nenit 13; pikës 4 të nenit 16; pikës 2 të nenit 24; pikës 4 të nenit 27; pikës 1 të nenit 31, pikës 2 të nenit 32;

b) ministri përgjegjës për gjuetinë miraton aktet nënligjore në përputhje me parashikimet e pikës 1 të nenit 5; pikës 4 të nenit 6; pikave 2 dhe 4 të nenit 7; pikës 3 të nenit 10; pikave 4 dhe 6 të nenit 15; pikës 1 të nenit 25; pikës 6 të nenit 26; pikës 2 të nenit 31; pikës 5 të nenit 34; pikës 1 të nenit 36; pikës 1 të nenit 37; pikës 2 të nenit 45 dhe pikës 4 të nenit 47;

c) ministri përgjegjës për gjuetinë, në bashkëpunim me ministrin e brendshëm, miraton aktin nënligjor në zbatim të pikës 2 të nenit 41.

Neni 52

Dispozita kalimtare dhe shfuqizime

1. Aktet nënligjore të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, të cilat nuk bien ndesh me të, mbeten në fuqi dhe do të zbatohen deri në miratimin e akteve të reja nënligjore, në zbatim të këtij ligji.

2. Përfundimisht, deri në miratimin e Programit Kombëtar të Zhvillimit të Gjuetisë dhe Planit të menaxhimit 10-vjeçar, menaxhimi i zonave të gjuetisë bëhet rast pas rasti, duke u mbështetur në planin vjetor të përdorimit të zonës së gjuetisë të miratuar nga bashkia.

3. Gjuetia nuk mund të ushtrohet në asnjë zonë pa miratuar planin vjetor të përdorimit të zonës së gjuetisë.

4. Deri në përzgjedhjen e menaxhuesit të zonës së gjuetisë, sipas procedurës së përcaktuar në këtë ligj, të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë e menaxhuesit delegohen te njësi përgjegjëse që mbulon natyrën dhe biodiversitetin në njësinë e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

5. Ligji nr. 10 253, datë 11.3.2010, "Për gjuetinë", i ndryshuar, shfuqizohet.



6. Ligji nr. 60/2022 “Për shpalljen e moratoriumit të gjetisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 53

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 12.12.2025.

Shpallur me dekretin nr. 2, datë 6.1.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 2, datë 6.1.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 89/2025, “Për gjetinë”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë

